


# Buletini

**GUSHT 2023**



# Kryetari Ahmeti priti në takim Ministrin Elbert Krasniqi

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti i shoqëruar me bashkëpunëtorët e tijë, ka pritur në takim Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi me të cilin kanë diskutuar mbarëvajtjen e projekteve të fituara nga Komuna e Lipjanit në Grantin e Përfmormancës Komunale, të cilat shumica nga to kanë filluar së implementuari në teren.



# Komuna e Lipjanit ka mbajtur dëgjime publike lidhur me Planifikimin e Buxhetit për vitet 2024-2026

Gjatë këtyre dëgjimeve drejtori për Buxhet dhe Financa z. Latif Ramadani ka bërë elaburimin e buxhetit të komunës së Lipjanit me që rast i ka informuar të pranishmit rreth projeksioneve buxhetore për investimet kapitale të cilat do ti realizoj Komuna e Lipjanit.



***Në muajin gusht drejtorati për buxhet dhe financa, ka mbajtur konsultimet publike me qytetarët e komunës së Lipjanit lidhur me Planifikimin e Buxhetit 2024-2026. Konsultimet janë realizuar me banorët e fshatrave Grackë e Vjetër dhe Ribar i Madh ndërsa në orët e mbrëmjes dëgjimet buxhetore kanë vazhduar edhe me banorët e fshatit Baicë.***



# Nata finale e Mërgata Fest & Sport

Mbrëmjes finale “Mërgata Fest & Sport”, iu bashkuan qytetarë të shumtë në aktivitete dhe përjetuan nga afër atmosferën festiveqë po mbretëronte në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan. Me një super mbrëmje, me atmosferë dhe energji fantastike u përmbyll edhe nata e tretë dhe finale e festivalit tashmë tradicional “Mërgata Fest & Sport”, organizuar për nderë të bashkatdhetarëve nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport nën patronatin e kryetarit z. Imri Ahmeti.



***Në kuadër të aktiviteteve për Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, të organizuara nën patronatin e kryetarit të komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, me moton "një ditë kryetar", filloi aktiviteti i parë me të rinjtë e Lipjanit në zyrën e kryetarit të komunës të cilët ngrohtësisht u pritën nga nënkryetari i Komunës Diamant Bytyqi, Drejtoresha e DRSK-së Anila Reçica dhe Zëdhënësja e Komunës Hyra Bytyqi.***



***Komuna e Lipjanit, si pjesë e partneritetit me UNICEF-in, ka përfituar nga Raiffeisen Bank një automjet si donacion për Qendrën për Punë Sociale në Lipjan. Kjo iniciativë synon të mbështesë familjet më në nevojë, duke siguruar kështu mbështetje dhe shërbime themelore për ta.***



# Mbahet konferenca vjetore për rini me temën “Roli dhe fuqizimi i rinisë në komunën e Lipjanit”

Në bibliotekë qytetit në bashkëpunim me organizatën YAHR është mbajtur konferenca vjetore për rini, ku panelist ishte nënkryetari i komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, drejtoresha znj. Anila Reçica Llugiqi si dhe drejtori i organizatës YAHR z. Bekim Krasniqi.






**Instituti GAP ka publikuar matjen e Indeksit të Transparencës Buxhetore të Komunave, në këtë raport Komuna e Lipjanit rendit ndër të parat me transparencë më të lartë. Transparenca është dhe do të jetë parimi jonë i palëkundur. Këtë e dëshmon edhe Indeksi i Transparencës Buxhetorenga Instituti GAP.**

# INDEKSI I TRANSPARENCËS BUXHETORE TË KOMUNAVE

**Figura 1.** Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2022



# Komuna e Lipjanit ka nënshkruar Marrëveshje të Bashkëpunimit me Islamic Relief Kosova

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z.Diamant Bytyqi dhe drejtori i fondacionit Islamic Relief në Kosovë, dr.Muhamed Soliman, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje u nënshkrua me qëllim të mbështetjes së familjeve të fermerëve nga Komuna e Lipjanit të cilat do të ndihmohen me serra dhe motokultivatorë.



***Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Drejtoreshën e aktivitetit të USAID-it, Qeverisja e Pronës, znj. Jennifer Ober, me të cilën kanë diskutuar rreth implementimit të projektit i cili po zbatohet nga Aktiviteti Qeverisja e Pronës të financuar nga Komuna e Lipjanit dhe USAID-i.***



***Në kuadër të projektit “Integriteti i Komunave të Kosovës”, mbështetur nga USAID Kosova, për përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit u organizua punëtori me temën “Planifikimi i Buxhetit për vitet 2024-2026”.***



# Shkollat e Komunës së Lipjanit gati për fillimin e procesit mësimor

Në sallën e Kuvendit të Komunës, drejtori i Arsimit z. Rasim Hasani ka zhvilluar takim pune me drejtorët e shkollave ku u diskutua për fillimin e procesit mësimor për vitin e ri shkollor 2023-2024.



# Shpallje për fermer

Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari në Komunën e Lipjanit dhe “Islamic Relief Kosova” shpallin thirrjen për aplikim për përkrahjen e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 100m<sup>2</sup> dhe motokultivator.

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit. Marrja e aplikacioneve si dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në zyrët pritëse në Qendren për Shërbime me Qytetar.

(Për shkak të mos funksionimit për publikim në Web-faqe të Komunës së Lipjanit, për kriteret dhe dokumentacionet e nevojshme, thirrja gjendet e publikuar në tabelen e shpalljeve para objektit të komunës).



---

## SHPALLJE

PËR PËRKRAHJEN  
E FERMERËVE ME  
SERRA DHE  
MOTOKULTIVATOR

---



# Mbahet mbledhja e rregullt e KKSB-së

Kryesuar nga nënkryetari i komunës, z. Diamant Bytyqi, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB, ka mbajtur takimin e rregullt, të katërtin për këtë vit, ku u diskutua për gjendjen e sigurisë në komunën tonë.



# Të nderuar përfaqësues të bizneseve

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ka përgatitur një anketë të shkurtër për vlerësimin e gjendjes aktuale si dhe vlerësimin e nevojave për bizneset në Komunën e Lipjanit.

Nëse jeni biznes dhe operoni në Komunën e Lipjanit ju lutemi gjeni pak kohë dhe plotësojeni anketën e bashkangjitur me këtë njoftim.

Anketa si e tillë do tu dërgohet edhe përmes emailit bizneseve të cilat e kanë të deklaruar email adresën në sistemin e ARBK-së.

Përgjigjet tuaja janë me rëndësi për në dhe do të shqyrtohen me përkushtim.

Ju faleminderit!

<https://docs.google.com/.../1FAIpQLSedoCDTr6y.../viewform...>



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**OPŠTINA LIPLJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim  
Ka përgatitur anketë për bizneset e  
Komunës së Lipjanit


**ANKETË PËR  
BIZNESET  
NGA KOMUNA  
E LIPJANIT**





# Lipjani komuna e parë në Kosovë që lanson platformën “Harta Dixhitale Komunale”

Komuna e Lipjanit është komuna e parë në Kosovë që ka lansuar platformën “Harta Dixhitale Komunale”. Kjo platformë synon ofrimin e një qasje më të lehtë në pronat komunale dhe rritjen e transparencës dhe efikasitetit, e që nga sot është e qasshme nga të gjithë qytetarët të cilët mund të informohen në kohë reale për një numër të madh të të dhënave gjeohapësinore zyrtare duke përfshi të dhënat e pronave komunale, urbanizmit, adresat, institucionet, etj. Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti tha se është i lumtur që komuna e Lipjanit është e para në nivel vendi që po lanson një hartë të tillë.




# Mbahet takimi i radhës i Këshillit Publiko – Privat

Nën kryesimin e nënkryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi u mbajt takimi i tretë i rregullt i Këshillit Publiko – Privat, organizuar në bashkëpunim me programin e USAID-it, Qeverisja e Pronës.



# Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



[infokomuna.lipjan@rks-gov.net](mailto:infokomuna.lipjan@rks-gov.net)



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë